



Shoqata e të Verbërve të Kosovës
Kosova Association of the Blind
Udruzenje Slepih Kosova

Plani Strategjik

2019-2024

Prishtinë, Prill 2019

Përmbledhje ekzekutive

Hyrje

Procesin e zhvillimit të planit strategjik 2019-2024 të SHVK-së e ka përkrahur donatori i përhershëm Agjensioni Çek për Zhvillim në bashkëpunim me OJQ-në People in Need. Me këtë rastë falenderojmë popullin Çekë

Për SHVK

SHVK është vazhdimësi e Lidhjes së të verbërve të Kosovës e themeluar në vitin 1947 dhe e riorganizuar në vitin 2003.

SHVK është organizatë jo qeveritare, jo profitabile e regjistruar pranë institucioneve përkatëse, e cila angazhohet për mbrojtjen, përfaqësimin dhe afirmimin e interesave dhe të drejtave të qytetarëve të verbër, pa dallim moshe, gjinie, përkatësie etnike dhe fetare.

SHVK, angazhohet në vazhdimësi për zbatueshmërinë e plotë të Ligjit për të verbër (04/L-092) Si rrjedhojë, integrimi i personave të verbër në jetën publike dhe aftësimi i tyre për jetë të pavarur është një nga sfidat më të mëdha dhe synimi kryesor i SHVK.

Politikat zhvillimore të SHVK fokusohen edhe në faktorizimin e çështjeve që kanë të bëjnë me personat e verbër, dhe vetëdijësim të qytetarëve për përkrahje ndaj tyre. Këto politika implementohen përmes fushatave avokuese, debateve publike, konferencave, publikimeve të ndryshme, etj.

SHVK bashkëpunon me organizatat simotra, institucionet publike dhe me palët e tjera me interes me qëllim që të arrihen rezultate të kënaqshme, duke qenë në koordinim dhe përputhshmëri me organizmat dhe politikat të cilat aprovohen. SHVK në cilësinë e vëzhguesit merr pjesë në të gjitha takimet që organizohen nga Unioni Evropian i të verbërve, Komiteti Konsultativ Ballkanik i të Verbërve dhe Unioni i të Verbërve të Botës.

SHVK vepron në gjithë territorin e Kosovës, përmes rrjetit të saj të përbërë nga gjashtë shoqata ndëkomunale dhe shtatë shoqata komunale. Shoqata ka organet e veta legjitime të zgjedhura në mënyrë demokratike. SHVK ka Kuvendin si organ vendimmarrës, kryetarin, Këshillin Drejtues dhe Këshillin e Përgjithshëm.

Departamenti për Ofrimin e Shërbimeve dhe Resurseve Njerëzore

SHVK në vitin 2012 ka themeluar Departamentin për ofrimin e shërbimeve specifike profesionale. Duke pasur parasysh, në mos përmbushjen ligjore për ofrimin e këtyre

shërbimeve nga ana Institucioneve relevante shtetërore, SHVK ka marrë përsipër që, shërbimet në fjalë t'i aplikoj falë ngritjeve të kapaciteteve njerëzore për dhënien e këtyre shërbimeve.

Shërbimet kryesore që ofron ky departament janë:

1. Shërbimet në Teknologjinë Informativë Asistuese
2. Shërbimet në shkrim dhe lexim në Brail;
3. Orientim në Hapësirë, Mobilitet dhe Shkathtësi ditore dhe
4. Shërbime Psiko- Sociale.

Të gjitha shërbimet që ofrohen ky departament për ofrimin e shërbimeve profesionale, bëhen paraprakisht bazuar në nevojat e komunitetit, të identifikuara përmes Shoqatave Komunale dhe Ndërkomunale. Kjo qendër ka drejtorinë, koordinatorët për çdo sferë të shërbimeve dhe trajnerët e certifikuar për ofrimin përkatës.

Departamenti për Ofrimin e Shërbimeve posedon pajisjet e duhura për ofrimin e shërbimeve të lartpërmendura, të cilat janë të donuara nga Agjensioni Çek për Zhvillim.

Vizioni

Personat e verbër, qytetar të barabartë, të pavarur dhe kontribuues në shoqëri.

Misioni

Ne përfaqësojmë personat e verbër duke kontribuar në socializim, edukim, punësim dhe rehabilitim, duke u angazhuar dhe besuar në gjithëpërfshirës dhe pavarësim të tyre.

Vlerat dhe parimet

- Struktura e organizatës e shtrirë në gjithë vendin
- Gjithëpërfshirja e të gjitha etnive në vend
- Partneriteti kombëtar dhe ndërkombëtar
- Puna ekipore
- Llogaridhënia
- Transparenca
- E drejta ligjore për përfaqësim
- Përgatitja specifike profesionale

- Çdo person ka të drejtën e bashkimit për promovimin e të drejtave, lirisë dhe interesave të tij/saj.

- Çdo person i verbër ka të drejt të eksploroj potencialin e tij dhe talentin për pjesëmarrje në komunitet
- Çdo person ka të drejtën për punësim, pjesëmarrje politike, lëvizshmëri dhe drejtësi sociale pa diskriminim
- Çdo grua dhe fëmijë i verbër ka të drejtën për arsim dhe mbrojtjen nga diskriminimin, ngacmimi seksual dhe abuzimi

SWOT Analiza

Për të lehtësuar hartimin e Prioriteteve dhe Objektivave strategjike, Grupi punues ka analizuar gjendjen e përgjithshme të SHVK dhe ka identifikuar anët e forta dhe të dobëta të brendshme si dhe mundësit dhe kërcënimet nga ambienti i jashtëm.

Anët e forta:

Menaxhimi i zgjedhur në mënyrë demokratike me mandat deri në vitin 2023. Strukturë organizative e konsoliduar. Bashkëpunimi i mirë në mes të degëve. Transparenca në nivel të duhur (Pasqyra financiare të audituara). Vendimmarrja përmes diskutimit dhe në konsultim me menaxhmentin. Stafi profesional i lincësuar dhe i motivuar. Infrastrukturë e mjaftueshme në shumicën e degëve (disa zyre janë në pronësi). Posedimi i pajisjeve profesionale teknologjike asistuese. Anëtarësia multietnike.

Anët e dobëta:

Mungesa e stafit profesional në degë. Financimi jo i mjaftueshëm. Mungesa e hapësirës në zyrat qendrore. Shoqata e pa licesuar për ofrimin e shërbimeve speciale. Mungesa e automjeteve. Mungesa e mjeteve asistuese dhe teknologjike të avansuara. Mungesa e digjitalizimit të të dhënave.

Mundësitë:

Zgjerimi i partneritetit me institucione publike, donatorët dhe OJQ-të lokale. Zgjerimi i partneritetit me bizneset vendore. Zgjerimi i partneritetit me institucione rajonale dhe ndërkombëtare. Shfrytëzimi i të drejtave në bazë të ligjit për të verbër dhe ligjeve të tjera. Shfrytëzimi i teknologjive të reja asistuese.

Kërcënimet:

Mungesa e akteve nënligjore për zbatimin e ligjeve ekzistuese. Mos përfshirja e përkrahjes financiare në Ligjin e buxhetit. Zvogëlimi i donacioneve nga donatorët e jashtëm.

Prioritetet dhe Objektivat Strategjike

1. Financimi i investimeve në shërbime efikase

Objektiva 1: Gjetja e mundësive për financim nga institucionet vendore, bizneset private dhe donatorët ndërkombëtar.

2. Ngritja e vetëdijes

Objektiva 2: Avokim dhe lobim te institucionet vendore për fuqizimi dhe zbatim të legjisllacionit aktual

3. Mbështetja e personave të verbër në edukim dhe punësim

Objektiva 3: Aftësimi i personave të verbër përmes mësimit gjithëpërfshirës dhe krijimi i mundësive për punësim dhe pavarësim

4. Përmirësimi i rezultateve përmes inovacionit dhe bashkëpunimit

Objektiva 4: Krijimi i sintezës vokale në gjuhën shqipe dhe aplikimi i teknologjive të reja për asistimin e personave të verbër

5. Punësimi i stafit profesional dhe mbajtja e stafit ekzistues

Objektiva 5: Ngritja e kapaciteteve për ofrimin e shërbimeve cilësore dhe specifike për personat e verbër

Objektivat	Aktiviteti	Treguesit e matshme	Personi përgjegjës	Afatet kohore	Kostot e përafërta
Objektiva 1: Gjetja e mundësive për financim nga institucionet vendore, bizneset private dhe donatorët ndërkombëtar	1.1 Aplikimi në të gjitha thirrjet publike për financimin e projekteve	Numri i aplikimeve	Departamenti për Zhvillimit të projekteve dhe ngritjeve të fondeve	2019-2024	Kosto administrative
	Hulumtimi/vizitat te bizneset private	Numri i bizneseve te vizituara	Departamenti për Zhvillimit të projekteve dhe ngritjeve të fondeve	2019-2024	Kosto administrative
Objektiva 2: Avokim dhe lobim te institucionet vendore dhe ndërkombëtarë për fuqizimi dhe zbatim të legjislacionit aktual	2.1 Vizitat zyrtare te institucionet publike	Numri i vizitave	Zyra e kryetarit	2019-2024	Kosto administrative
	2.2 Kampanja të ndryshme informuese	Numri i kampanjëve	Departamenti i Administratës	2019-2024	Kosto sipas projekteve
	2.3 Pjesëmarrja në konferenca të ndryshme ndërkombëtare	Numri i konferencave	Zyra e Kryetarit	2019-2024	
Objektiva 3: Aftësimi i personave të verbër përmes mësimit gjithëpërfshirës dhe krijimi i mundësive për punësim dhe pavarësim	3.1 Mbajtja e trajnimeve specifike	Numri i trajnimeve	Departamenti i Ofrimit të Shërbimeve dhe Resurseve Njerëzore	2019-2024	Sipas projekteve
	3.2 Lobim para institucioneve arsimore	Numër i takimeve	Zyra e Kryetarit	2019-2024	Kosto administrative
	3.3 Lobimi te bizneset private dhe institucionet publike	Numri i takimeve	Zyra e Kryetarit	2019-2024	Kosto administrative
Objektiva 4: Krijimi i sintezës vokale në gjuhën shqipe	4.1 Lobim për krijimin e sintezës vokale para institucioneve	Numri i takimeve	Zyra e kryetarit	2019-2021	Kosoto administrative

dhe aplikimi i teknologjive të reja për asistimin e personave të verbër	vendore dhe ndërkombëtare 4.2 Avokim për zbatimin të ligjit (04/L-092) të nenit 10.3	Numri i takimeve	Departamenti i Ofrimit të Shërbimeve dhe Resurseve Njerëzore	2019-2024	Kosto administrative
Objektiva 5: Ngritja e kapaciteteve për ofrimin e shërbimeve cilësore dhe specifike për personat e verbër	5.1 Trajnime adekuate profesionale 5.2 Sigurimi i ambienteve të punës, pajisjeve dhe programeve adekuate	Numri i trajnimeve	Departamenti i Ofrimit të Shërbimeve dhe Resurseve Njerëzore	2019-2024	Sipas projekteve
		Numri i pajisjeve dhe zyreve	Departamenti i Administratës	2019-2021	Sipas projekteve

Pjesmarrësit në hartimin e planit strategjik

1. Daut Tishuki- Kryetar
2. Mexhit Foniqi- Drejtor i Administratës
3. Bekim Krasniqi - Departamenti i Ofrimit të Shërbimeve dhe Resurseve Njerëzore
4. Melihate Pllana -zyrtare për Zhvillimi të projekteve dhe ngritjeve të fondeve dhe Asistente ne zyrën e kryetarit
5. Hajrie Xhemali- Finaciare
6. Emine Prekaj-Kuqi – Menaxhere e njësisë së shtypjes dhe përpunimit të materialeve
7. Ejup Qerimi – Fasilitues nga D&D BCS

Adresa: “Bregu i Diellit”, Rr. Rifat Burgjeviç, pa numri, I lamella V, 100000, Prishtinë, Kosovë